

PUNË DINJITOZE NË SEKTORIN E MEDIAS

Sektori i medias përbën një fushë të ndryshme dhe dinamike të tregut të punës, duke përfshirë punonjës që operojnë në televizion, radio, shtyp të shkruar, media online dhe formate të tjera të komunikimit publik. Kjo natyrë e larmishme e shërbimeve e bën sektorin unik në sfidat që paraqet, si dhe në mundësitë që ofron. Ky kompleksitet kërkon një vëmendje të veçantë për garantimin e të drejtave të punëtorëve dhe zbatimin e standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë në këtë sektor.

ÇFARË DUHET TË DINI SI PUNËMARRËS:

- **Kontratat dhe forma të punës:** Shumë punonjës punojnë me kontrata të përkohshme ose freelance. Sigurohuni që kontrata juaj të jetë e qartë për pagesën, orarin, detyrat dhe kushtet tuaja të punës.
- **Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore:** Ju keni të drejtë për mbrojtje sociale sipas ligjit, duke përfshirë pagesën e sigurimeve, pushime të paguara dhe kujdes shëndetësor.
- **Punë e sigurt dhe pa diskriminim:** Punëdhënësi duhet të sigurojë një ambient pune të përshatshëm, të sigurt, të lirë nga ngacmimet dhe diskriminimi.
- **Orari i punës:** Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë. Kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë.
Puna jashtë orarit paguhet sipas ligjit.
- **Orët shtesë të punës – Si kompensohen:**
 - Kompensohen me Pagese: Nëse punoni më shumë se orët e zakonshme dhe nuk merrni pushim, punëdhënësi duhet t'ju paguajë pagën normale plus një shtesë të paktën 25%.
 - Kompensimi me pushim: Me marrëveshje me punëdhënësin, orët shtesë mund të kompensohen me pushim që është 25% më i gjatë se koha e punuar shtesë, dhe merren brenda 2 muajve nga dita e kryerjes së punës.
 - Orët shtesë gjatë pushimit javor ose festave zyrtare: Kompensohen me pushim ose pagesë të paktën 50% më e madhe se paga normale ose pagesa për orët shtesë.

Shënim: Në disa raste kontrata kolektive mund të parashikojë dispozita të tjera mbi kushtet e punës por në asnjë rast më pak të favorshme se ato të parashikuara në aktet ligjore.

Puna gjatë natës – E drejta për kompensim:

- **Ora 19:00 – 22:00**

Çdo orë pune gjatë këtij intervali paguhet jo më pak se +20% mbi pagën normale.

- **Ora 22:00 – 06:00**

Çdo orë pune gjatë natës paguhet jo më pak se +50% mbi pagën normale.

Puna gjatë pushimit javor dhe festave zyrtare

Pushimi javor, puna kompensohet me:

- Pagesë shtesë të paktën 25% mbi pagën normale, ose
- Pushim i pagueshëm, që përfshin kohën e punës plus 25% shtesë.

Ditët e festave zyrtare që bien ditë pune, puna kompensohet me:

- Pagesë shtesë të paktën 25% mbi pagën normale, dhe
- Pushim i pagueshëm për kohëzgjatjen e punës së kryer.

Pushimi javor

Çdo punonjës ka të drejtë për minimum 36 orë pushim në javë, prej të cilave 24 orë radhazi pa ndërprerje. Ky pushim garanton kohë të mjaftueshme për të rikuperuar energjinë dhe shëndetin.

Pushimet vjetore

Çdo punonjës ka të drejtë për minimum 22 ditë pune pushim gjatë vitit. Kjo është e drejta juaj për të pushuar dhe për t'u rikuperuar gjatë vitit.

Siguria dhe shëndeti në punë

Punonjesit në media gëzojnë çdo të drejtë për siguri dhe shëndet në vendin e punës.

Kjo garanton që puna të kryhet në kushte të sigurta dhe pa rrezik për shëndetin.

Mbrojtja në vendin e punës

Punonjësit kanë të drejtë për mbrojtje nga stresi i punës, ngacmimi psikologjik ose çdo formë presioni që cënon integritetin profesional.

Çdo punonjës duhet të ndihet i sigurt dhe i respektuar në vendin e punës.

ÇFARË DUHET TË DINI SI PUNËDHËNËS:

- Lidhja e kontratave individuale të punës nënshkruar me çdo punonjës.
- Sigurimi i kushteve të sigurta të punës duke përfshirë vlerësimin e riskut në terren, studio apo zyra.
- Respektimi i orareve ligjore të punës dhe shmangia e abuzimit me kontratat e përkohshme.
- Pagesë e drejtë dhe transparente, jo më pak se paga minimale ligjore.
- Mbajtja e dokumentacionit të rregullt mbi marrëdhëniet e punës dhe pagesat.
- Parandalimi i çdo forme diskriminimi ose presioni ndaj punonjësve, duke respektuar pavarësinë profesionale.
- Dialog social: Bashkëpunoni me punonjësit dhe sindikatat për të adresuar sfidat dhe për të krijuar politika të qëndrueshme pune.

Qëllimi i këtij informacioni është të informojë dhe mbështesë punonjësit për të ushtruar të drejtat e tyre dhe për të punuar në kushte të sigurta dhe të drejta.

Këshilla e fundit: Njihni të drejtat tuaja dhe respektoni të drejtat e të tjerëve. Punë dinjitoze është e drejtë për të gjithë, pavarësisht nga lloji i kontratës apo fusha e punës.

Pse është e rëndësishme kjo?

Punonjësit e medias shpesh punojnë në kushte me orare të zgjatura dhe presion profesional.

Respektimi i ligjit garanton shëndet dhe siguri në punë, dinjitet profesional dhe cilësi të lartë të shërbimit publik mediatik. Për punëdhënësit, zbatimi i rregullave forcon besueshmërinë dhe etikën profesionale të medias në zbatim të misionit të saj.

Kontakto Inspektoratin e Punës

Web: www.inspektoriatipunes.gov.al

Email: info@slj.gov.al

Tel.: +355042368466

Inspektorati Shtetëror i Punës në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive

